



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 533/44 Prot.

Tiranë më 30.12. 2015

V E N D I M

Nr. 135, datë 30.12. 2015

"Për rivlerësimin e pikës 7, të vendimit nr. 3898/1 prot., datë 29.09.2015, të Departamentit të Administratës Publike, mbi transferimin e përhershëm të nëpunësit ** , në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural".***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet kërkesave të disa nëpunësve të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë (nr. 533 prot., datë 20.07.2015, të punonjësit ***** ; nr. 573 prot., datë 31.07.2015, të punonjësit ***** dhe nr. 533/5 prot., datë 12.08.2015, të punonjësit *****), ka marrë dijeni në lidhje me disa shkelje të lejuara në momentin e kryerjes së transferimit të përhershëm të tyre, për shkak të ristrukturimit të institucionit, nga Drejtoria e Bujqësisë Tiranë në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (edhe ky, institucion vartësie i Ministrisë së Bujqësisë).

Duke qenë se, nga informacioni i marrë kanë lindur dyshime të arsyeshme se në rastet e tyre nuk ishin respektuar të drejtat e nëpunësit civil të mbrojtura me ligj, me urdhrin nr. 533/1 prot., datë 31.07.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar procesin e verifikimit të informacionit.

Pas komunikimit të këtij urdhri, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 3824/1, datë 20.08.2015 (protokolluar në KMSHC me nr. 533/6 prot., datë 21.08.2015), ka vënë në dijeni Komisionerin se, në kuadër të ushtrimit të kompetencës për mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, e kishte konstatuar këtë parregullsi në mënyrën e zbatimit të ligjit nga ana e njësisë së personelit dhe Komisionit të Ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë dhe për këtë arsye kishte vendosur rishqyrtimin e të gjithë procesit.

Në këto rrethana, për të krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin e kompetencave prej Departamentit të Administratës Publike, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 91, datë 10.09.2015, ka vendosur të pezullojë procesin e verifikimit për këto raste, deri në përfundimin e procedurës së rishqyrtimit dhe rivlerësimit të procesit nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP).

Me përfundimin e kësaj procedure, Departamenti i Administratës Publike, pasi ka marrë vendimin përfundimtar në lidhje me transferimet e përhershme, për shkak të ristrukturimit të institucionit, me shkresën nr. 533/9, datë 14.10.2015, ka njoftuar Komisionerin në lidhje me ecurinë e procesit. Në

këto rrethana, Komisioneri, me aktin administrativ nr. 123, datë 09.11.2015, vendosi heqjen e masës së pezullimit dhe vazhdimin e hetimit administrativ për verifikimin e këtyre rasteve të evidentuara.

I. *Pas verifikimit të dokumentacionit të dërguar nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, (me shkresën nr. 533/5 prot., datë 12.08.2015) dhe atij të administruar drejtpërdrejtë në njësinë e personelit të këtij institucioni, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ, ka rezultuar se:*

Drejtoria e Bujqësisë Tiranë, në fillim të vitit 2015, në bazë të strukturës organizative të miratuar me Urdhrin nr. 113, datë 10.03.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive të Bujqësisë”, ka pasur gjithsej 60 vende pune, nga të cilat 54 pozicione përfshiheshin në shërbimin civil (prej këtyre të fundit, tre pozicione ishin vende vakante).

Më pas, me Urdhrin nr. 54, datë 24.04.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive të Bujqësisë”, ka pësuar ndryshim të strukturës dhe organikës, duke shënuar ulje të numrit të punonjësve të tyre. Konkretisht, struktura e Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, sipas skemës 2/1, bashkëlidhur këtij urdhri, parashikonte gjithsej 57 vende pune, nga të cilat 51 pozicione, ishin pjesë e shërbimit civil, duke pakësuar me 3 (tre) pozicione pune të kategorisë ekzekutive, me emërtimin “Specialist”, në Sektorin e Shërbimit Këshillimor.

Në zbatim të strukturës së re, Departamenti i Administratës Publike, me aktin administrativ nr. 38, datë 06.05.2015, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në Kuadër të Ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë”, ka urdhëruar krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, përbërja e të cilit rezulton se është në përputhje me kërkesat e ligjit.

Ky organizëm, në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kreut III, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, ka filluar menjëherë shqyrtimin e mundësive të sistemimit të çdo nëpunësi civil, në vendet e mbetura pas riorganizimit; ka përgatitur propozimet përkatëse për transferimin e nëpunësve në pozicionet e mbetura e të ristrukturuara, duke ruajtur nivelet e kategorive. Po kështu ka kryer gjithë veprimet e tjera që i ngarkohen nga dispozitat e mësipërme, për lirin nga detyra të atyre nëpunësve, të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës, ose që nuk mund të sistemohen për shkak se nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme e të veçanta të ndonjë prej pozicioneve të mbetura.

Në përfundim të punës së tij, Komisioni i Ristrukturimit, me shkresën nr. 489 prot., datë 12.06.2015, ka dërguar propozimet përkatëse Departamentit të Administratës Publike, i cili në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhej të merrte vendimin përfundimtar të transferimit, për çdo nëpunës.

Në këto propozime, ndërmjet të tjerave, ishte parashikuar që punonjësit ***** (pika 8), ***** (pika 6) dhe ***** (pika 7), të transferohen pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (institucion i cili nuk përfshihet në fushën e shërbimit civil).

Ndërkaq, njësia e administrimit të burimeve njerëzore, pranë Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, pa pritur që njësia përgjegjëse (DAP), të shqyrtojë aktet dhe të marrë vendimin përfundimtar, ka ekzekutuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, duke transferuar nëpunësit pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Në kushtet kur, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural është institucion që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësit ***** , ***** dhe ***** nuk marrin statusin e punësimit në shërbim civil.

Ata duke mos pranuar aktin e emërimit, kanë kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbrojtjen e statusit të punësimit dhe trajtimin e rasteve të tyre, sipas kritereve dhe kërkesave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në vijim, me marrjen dijeni për këtë informacion, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka urdhëruar fillimin e procesit të verifikimit të këtyre precedentëve, duke njoftuar për këtë vendim Departamentin e Administratës Publike.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit përfundimtar të Departamentit të Administratës Publike, rezulton se, ky i fundit nuk e ka miratuar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e nëpunësve ***** dhe ***** pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, duke urdhëruar kthimin e tyre në pozicionin që kishin pasur para ristrukturimit.

Në kushte të tilla, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se, lidhur me këta punonjës, nuk ka një objekt për t’u shprehur, pasi çështja është zgjidhur nga njësia përgjegjëse (DAP) në këtë rast, në përputhje me kriteret dhe kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Por, ndryshe nga dy rastet e mësipërme, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 3898/1 prot., datë 29.09.2015 (*shiko pikën 7, pasi vendimi është në formë të listuar, jo individual*) ka miratuar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit, për transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, i cili ishte në të njëjtat kushte me dy rastet e trajtuara më lart.

Sipas përcaktimeve të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, transferimi i nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, në një pozicion tjetër, për shkak se pozicioni i mëparshëm është shkurtuar, bëhet duke ruajtur kategorinë e nivelit të punësimit dhe gjithmonë, brenda sistemit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga analiza e përmbajtjes dhe elementëve të transferimit, në rastin konkret janë lejuar disa parregullsi dhe shkelje të kërkesave ligjore, pasi nuk është respektuar kushti që transferimi të kryhet në një pozicion tjetër të shërbimit civil. Institucioni, ku është transferuar nëpunësi ***** është jashtë fushës së veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ky përfundim është arritur nga analiza e përmbajtjes së nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, sipas të cilës krijohet Agjencia e Pagesave dhe përcaktohet se kjo agjenci është ent publik në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe se organizimi, funksionimi shtrirja territoriale dhe mënyra e rekrutimit të punonjësve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (*pika 3 e nenit 21 të këtij ligji*).

Në bazë të kësaj dispozite, ka dalë Vendimi nr. 1443, datë 31.10.2008 i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)”, në pikën 1 të cilit, përcaktohet se, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është e njëjtë me Agjencinë e Pagesave për të cilën flet ligji në fjalë.

Vendimi nr. 1443, datë 31.10.2008 i Këshillit të Ministrave, është shfuqizuar me Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave dhe në këtë të fundit, është rikonfirmuar fakti se kjo agjenci është institucion në varësi të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, duke e konsideruar si një ent publik që ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas. Në bazë të pikës 9, të këtij vendimi, marrëdhëniet e punësimit të këtij institucioni rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

Nisur nga këto dispozita dhe nga përmbajtja e pikës “e” të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas të cilës, ndërmjet të tjerave, përjashtohen nga fusha e veprimit të këtij ligji, “personeli i njërive publike direkte të shërbimit”, konstatohet se Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nuk përfshihet në sistemin e shërbimit civil. Kalimi i nëpunësit *****

***** , në një pozicion pune të kësaj agjencie, pa pëlqimin e tij, vjen në kundërshtim me rregullin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këto arsye, bazuar në nenin 115 pika “a”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, akti nr. 3898/1 prot., datë 29.09.2015 (pika 7, e tij), i Departamentit të Administratës Publike, që kalon nëpunësin ***** pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, është një akt absolutisht i pavlefshëm (në kundërshtim flagrant me ligjin) dhe si i tillë, duhet të revokohet.

Rasti duhet të rivlerësohet sipas kërkesave të legjislacionit që rregullon shërbimin civil dhe vetëm nëse nëpunësi në fjalë jep pëlqimin për të kaluar në atë pozicion pune jashtë shërbimit civil, duhet t’i krijohet mundësia që të përfitojë nga kushtet e përcaktuara në pikën 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që brenda një periudhe 2-vjeçare, të ketë mundësi të konkurrojë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë (nenet 25 dhe 26 të këtij ligji), etj.

Veç kësaj konstatohet se, mosmarrja e mendimit me shkrim të nëpunësit civil, për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar, ashtu si përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, është një fenomen që është hasur në gjithë praktikën e këtij ristrukturimi.

Po kështu, konstatohet se në këtë praktikë administrative aktet e njësisë përgjegjëse për qëndrimin përfundimtar ndaj propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, janë konceptuar në formën e një liste, ku përfshihen të gjithë punonjësit e institucionit dhe jo në mënyrë individuale, siç e kërkon pika 19, e Kreut III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, si dhe pikës 13, të kreut II “Krijimi dhe funksionimi i komisionit të ristrukturimit”, të Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, “Krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.

Për këto arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17 datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, të revokojë pikën 7, të vendimit nr. 3898/1 prot., datë 29.09.2015, të Departamentit të Administratës Publike, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se, “ ***** , transferohet në pozicionin, Specialist pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural” dhe rasti i tij të rishqyrtohet, duke respektuar të gjitha kushtet dhe kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.
2. Njësia përgjegjëse, të nxjerrë në mënyrë individuale vendimet e transferimit të nëpunësve pas ristrukturimit dhe të marrë mendimin e tyre me shkrim për pranimin e pozicionit të ofruar, me qëllim që të administrohen në dosjet e personelit (*dosjet individuale*).
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative institucionit i lihet afat **15** ditë nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Njësia e Personelit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë si dhe nëpunësi ***** .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA